



SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR - HANDIKOS FERIZAJ
ASSOCIATION OF PERSONS WITH DISABILITY - HANDIKOS FERIZAJ



RAPORTI VJETOR 2023

PËRMBAJTJA

◆ Parathënie.....	1
◆ Përmbledhje ekzekutive	3
◆ HYRJE.....	4
◆ Projektet e implementuara përgjatë 2023.....	8
◆ Shërbimet e ofruara përgjatë 2023.....	11
○ Shërbimet ditore për fëmijë.....	12
○ Shërbimet ditore për të rritur.....	15
○ Shërbimet e pajisjeve ndihmëse	18
○ Shërbimet juridike.....	20
○ Shërbime të tjera	21
◆ Intervenimet avokuese dhe lobuese.....	28
◆ Publikime.....	30

PARATHËNIE

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare e përkushtuar në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuar, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe avokimit.

Handikos Ferizaj punon për së afërmi me komunitetin, organizata të tjera si-motra, institucionet shëndetësore dhe autoritetet lokale e qendrore, për t'i shërbyer në mënyrë sa më efektive dhe të qëndrueshme përfituesve të saj.

HISTORIKU

Handikos Ferizaj ka qenë pjesë e HANDIKOS-it e cila është themeluar në vitin 1983 dhe fillimisht ka qenë e emëruar si Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve e Kosovës. Gjatë fazës emergjente të pas-luftës, HANDIKOS-i është shndërruar në ofrues të shërbimeve duke tentuar të mbulojë disa nga nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Me këtë rast, HANDIKOS ka ofruar materiale ortopedike, sanitare dhe materiale për parandalimin e plagëve dekubitare. HANDIKOS ka vepruar në tërë Kosovën dhe ka ofruar shërbimet e njëjta për të gjitha komunitetet pa dallim etnie, feje dhe race. Dega në Ferizaj, së bashku me të gjitha degët e tjera të HANDIKOS-it, që nga viti 2015 është pavarësuar në aspektin administrativ e programor nga qendra në Prishtinë dhe tani është e regjistruar si OJQ në vete. Kjo shkëputje është bërë me planifikim paraprak me qëllim të forcimit organizativ të qendrave gjithandej Kosovës, rritjes së qëndrueshmërisë së shërbimeve të ofruara me bazë në komunitet dhe përmbushjes së nevojave të përfituesve në mënyrë më efikase.

VIZIONI:

Shoqëri gjithëpërfshirëse me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara.

MISIONI:

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare që punon në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes avokimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË:

Duke u bazuar në analizën e situatës së personave me aftësi të kufizuara, Handikos Ferizaj e sheh si të nevojshme që organizata të përqendrohet në tri objektiva kryesore strategjike. Këto tri objektiva janë:

1. Përmirësimi i politikave publike dhe rritja e zbatimit të ligjeve e strategjive relevante për personat me aftësi të kufizuara.
2. Rritja e cilësisë dhe njeherit zgjerimi i shërbimeve të ofruara me bazë në komunitet.
3. Rritja e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

Synimet tona kryesore gjatë 2023-ës kanë qenë të fokusuara në katër (4) objektiva:

- ❖ Avokimi dhe lobimi drejt mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
- ❖ Ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, të cilat janë primare dhe më se të nevojshme por që ende mbetin një sfidë;
- ❖ Mbështetja e personave me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre me mjete assistive;
- ❖ Ngritja e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara mbi të drejtat e tyre dhe personelit të Handikos Ferizaj.

Personat me aftësi të kufizuara përballen me shumë sfida e barriera në vendin tonë, ndër të cilat ende mbetin: qasja, edukimi, punësimi, mirëqenia si dhe respektimi dhe avancimi i të drejtave të tyre, duke u bazuar në legjislacionin e Kosovës dhe dokumentet tjera ndërkombëtare. Kur përmendim sfidat, gjithsesi këtu duhet përmendur në veçanti edhe sfidat me të cilat Handikos Ferizaj ballafaqohet, duke u bazuar 100 % në projekte, pa një mbështetje të përhershme të qëndrueshme kryesisht nga Komuna e Ferizajt sidomos kur kemi të bëjmë me shërbimet të cilat ende nuk ofrohen nga institucionet vendore.



Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë pjesë e integruar e shoqërisë në tërësi dhe atyre duhet t'u ofrohet mundësia drejt pavarësisht individual, ku përmes përvojës, talenteve dhe kapaciteteve të tyre të kontribuojnë në zhvillimin e shtetit tonë.



Enver Kosumi Drejtor

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti Vjetor – 2023 paraqet një pasqyrë përmbledhëse të të arriturave të Handikos Ferizaj përgjatë vitit 2023 në kuadër të programeve të implementuara. Të dhënat e raportuara janë të bazuara në të arriturat e Handikos Ferizaj në implementimin e projekteve të mbështetura nga donatorë vendorë dhe atyre të huaj. Përmes shërbimeve të ofruara përgjatë një viti për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara si dhe prindër/familjarë të tyre, Handikos Ferizaj ka vazhduar misionin e saj për të avancuar/përmirësuar situatën e personave me aftësi të kufizuar në vend.

Përgjatë një viti, Handikos Ferizaj ka ofruar shërbime direkte për **54 fëmijë** me aftësi të kufizuara me gjithsej 1693 shërbime. Njëkohësisht janë ofruar shërbime të pajisjeve ndihmëse për **101 persona** me aftësi të kufizuara në Kom un ë n e Ferizaj t. Handikos Ferizaj gjatë vitit 2023, përmes këshillave ligjore ka ndikuar në përmbushje të të drejtave njerëzore për personat me aftësi të kufizuara. Përgjatë një (1) viti, 60 të tilla janë ofruar për personat me aftësi të kufizuara, 6 prej të cilave kanë qenë ankesa.

Bashkëpunimi i ngushtë që Handikos Ferizaj ka vazhduar ta mbajë me organizatat e shoqërisë civile, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, organizatat ndërkombëtare, institucionet lokale dhe qendrore, shoqërinë, dhe vetë komunitetin e aftësisë së kufizuar, ka ndikuar dukshëm në funksionimin e përditshëm, adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara si dhe avancimin e situatës së tyre në shoqëri. Handikos Ferizaj vazhdon të punojë për një shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave njerëzore për personat me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht mungesës së statistikave vendore për numrin dhe pre valencën e aftësisë së kufizuar në vend, në data bazën e saj, Handikos Ferizaj numëron më shumë se 1000 anëtarë me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara të moshave, gjinive dhe etnive të ndryshme.

○ **Përfshirja sociale dhe parandalimi i përjashtimit social të personave me aftësi të kufizuar (2022-2023), mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkë financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut.**

❖ **Qëllim i përgjithshëm i projektit:**

- Përfshirja e interesave të personave me aftësi të kufizuar në politikat lokale përmes Hartimit të Planit Lokal të Veprimit për Shërbimet Sociale në Komunën e Ferizajt

❖ **Aktivitetet kryesore të projektit:**

- Përpilimi i pyetësorëve për intervistat me ofruesit e shërbimeve, personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët
- Grumbullimi i të dhënave përmes intervistave mbi shërbimet të cilat ofrohen dhe identifikimin e shërbimeve të nevojshme tjera për PAK e të cilat nuk ofrohen aktualisht.
- Takime pune me fokus grupe- Mostra për diskutime në fokus grup përbëhej nga familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga shërbimet, familjet e të rriturve me aftësi të kufizuar dhe fëmijët e grup moshës 14+ të rriturit me aftësi të kufizuar dhe grupet e llojeve të aftësisë së kufizuar.
- Publikimi i Raportit mbi gjendjen aktuale në fushën e shërbimeve sociale për persona me aftësi të kufizuar.
- Trajnimin dy ditor për grupin punues të Planit të veprimit për shërbime sociale, në fushën e të drejtave të PAK dhe shërbimeve sociale.
- Punësoria tre ditore për hartimin e planit të veprimit për shërbime sociale.
- Diskutimi publik i draftit të parë të Planit të veprimit për shërbime sociale
- Inkorporimi i rekomandimeve dhe finalizimi i Planit të veprimit për shërbime sociale
- Publikimi i Planit të veprimit për shërbime sociale.

○ **Shërbimet rehabilituese multidisciplinare të cilësisë së lartë për fëmijët me aftësi të kufizuar – mbështetur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve & Ministria e Drejtësisë.**

❖ **OBJEKTIVAT:**

- Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuar që të zhvillojnë aftësitë e tyre, praktikojnë pavarësinë dhe të mundësohet përfshirja e tyre në shkollë dhe jetën në komunitet, përmes ofrimit të shërbimeve rehabilituese multidisciplinare me bazë në komunitet të cilësisë së lartë.
- Mbështetja e familjeve për të tejkaluar vështirësitë dhe aftësimin e tyre për të përkrahur zhvillimin fizik, shoqëror dhe arsimor dhe për të avokuar për të drejtat e fëmijëve të tyre.
- Rritja e kapaciteteve të palëve të interesit në identifikimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, të përgjigjen/adresojnë këto nevoja dhe monitorojnë progresin si dhe përfshirjen e tyre në ngjarje dhe fushata promovuese për të drejtat e fëmijëve për të ndikuar në ndryshimin e qëndrimeve publike.

 Shërbimet rehabilituese psikosociale për fëmijët me aftësi të kufizuar – mbështetur nga Zyra e Presidencës së Republikës së Kosovës.

❖ **OBJEKTIVAT:**

- Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuar që të zhvillojnë aftësitë e tyre, praktikojnë pavarësinë dhe të mundësohet përfshirja e tyre në shkollë dhe jetën në komunitet.
- Mbështetja e familjeve për të tejkaluar vështirësitë dhe aftësimin e tyre për të përkrahur zhvillimin fizik, shoqëror dhe arsimor dhe për të avokuar për të drejtat e fëmijëve të tyre.

 Shërbimet e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi (RBB) për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara janë të fuqizuara dhe të qëndrueshme”. Mbështetur nga Unicef Kosovo Programme, në partneritet me USAID Kosovo dhe implementuar nga HANDIKOS.

❖ **OBJEKTIVAT:**

- Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuar që të zhvillojnë aftësitë e tyre, praktikojnë pavarësinë dhe të mundësohet përfshirja e tyre në shkollë dhe jetën në komunitet.
- Mbështetja e familjeve për të tejkaluar vështirësitë dhe aftësimin e tyre për të përkrahur zhvillimin fizik, shoqëror dhe arsimor dhe për të avokuar për të drejtat e fëmijëve të tyre.

Handikos Ferizaj përgjatë implementimit të shërbimeve të ofruara në Programit të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi, me mbështetje të kuadër të projekteve që ka implementuar përgjatë vitit 2023, të financuara nga donatorët vendor dhe të huaj, ka arritur të mbështesë 54 fëmijë me aftësi të kufizuara në regjionin e Ferizajt. Shërbimet kyçe të ofruara përgjatë këtij viti kanë mbështetur zhvillimin holistik të fëmijëve me theks në shkathtësitë ditore, zhvillimin kognitiv, fizik dhe atë emocional.


Handikos Ferizaj ka vazhduar vlerësimin e rregullt të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ekipi multidisciplinare i Handikos Ferizaj duke vënë **fëmijën në fokus** si dhe duke analizuar perspektivën e prindërve dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve (kur është aplikuar). Bazuar në rezultatet e vlerësimit, janë përpiluar plane individuale të intervenimit për çdo fëmijë përfitues, përderisa ri-shikimi i tyre është bërë në **baza tre (3) mujore** duke aplikuar procesin e ri-vlerësimit në të gjitha fushat e zhvillimit. Procesi i mbështetjes së fëmijëve përgjatë vitit raportues është zhvilluar përmes përdorimit shpërndarjes së materialeve didaktike dhe angazhimin e prindërve për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve, proces ky i cili ka kontribuar në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. E gjithë kjo në baza mujore është raportuar për çdo fëmijë përfitues, ku më pas të njëjtat janë ndarë edhe me prindërit/kujdestarët duke i përditësuar ata me progresin mujor për fëmijët e tyre.

Të dhënat nga vlerësimi bazë i fëmijëve dhe ato nga ri-vlerësimi i fundit i realizuar në Dhjetor 2023 tregojnë rezultate të kënaqshme të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara përgjatë një (1) viti, pavarësisht sfidave me të cilat janë ballafaquar fëmijët përfitues, ofruesit e shërbimeve si dhe prindërit e përfshirë në këtë proces.


Të ndara sipas gjinisë

54 fëmijë me aftësi të kufizuara		
	Vajza	Djem
	21	33

Shërbimet e ofruara përgjatë vitit 2023, ishin të orientuara në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve në fushën e komunikimit (ekspresive & receptive) shkathtësive ditore (personale, domestike & komunitare), socializim (lojë, argëtim & ballafaqim), motorikë (grosë & fine). Përgjatë një (1) viti në kuadër të shërbimeve të ofruara janë mbështetur fushat e zhvillimit të elaboruara sipër, përderisa nga mesatarja e zhvillimit e kalkuluar në vlerësimet fillestare për fëmijët përfitues prej 51% (niveli bazë i shkathtësive) është ngritur në 67% (progresi i arritur për një (1) vit) me 54 fëmijë me aftësi të kufizuara.



Fushat në të cilat është identifikuar progres i dukshëm përgjatë vitit 2023 janë ajo e komunikimit receptiv, shkathtësive ditore personale & domestike si dhe motorikës fine:



Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara përgjatë vitit 2023 ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve sociale me baze në komunitet. Në këto shërbime përfshihen:

- ✚ Shërbime fizioterapeutike,
- ✚ Shërbime psikologjike
- ✚ Shërbime Edukim jo-formal
- ✚ Shërbime Logopedi
- ✚ Shërbime psiko-sociale

- Gjatë vitit 2023, 17 fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar shërbime fizioterapie. Këto shërbime kanë qenë jetike për përmirësimin e gjendjes së tyre fizike dhe për rritjen e aftësive motorike, duke i ndihmuar këta fëmijë të arrijnë një nivel më të lartë të pavarësisë dhe të përfshirjes në aktivitetet e përditshme. Përveç trajtimeve rutinë, fizioterapia ka luajtur një rol thelbësor në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, duke përfshirë këshillimet për prindërit dhe kujdestarët për ushtrime që mund të realizohen në shtëpi. Këto ndërhyrje kanë qenë të mundësuar falë përkushtimit të stafit të specializuar dhe përpjekjeve për të siguruar që çdo fëmijë të marrë kujdesin më të mirë të mundshëm, të personalizuar sipas nevojave të tyre specifike.



- Në vitin 2023, 20 fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar shërbime psikologjike në qendrën Handikos Ferizaj. Këto shërbime kanë qenë thelbësore për përmirësimin e mirëqenies së tyre emocionale dhe sociale, duke i ndihmuar ata të përballojnë sfidat.



15 fëmijë me aftësi të kufizuara në Handikos Ferizaj kanë marrë shërbime logopedisë për të përmirësuar aftësitë e tyre të komunikimit. Këto shërbime kanë përfshirë terapi të personalizuar të folurës dhe gjuhës, përdorimin e metodave alternative për komunikim, dhe bashkëpunim me prindërit për të siguruar përparim të vazhdueshëm. Fëmijët kanë treguar përmirësime të dukshme në komunikim dhe janë bërë më të sigurt në ndërveprimet e tyre sociale. Handikos Ferizaj synon të zgjerojë këto shërbime për të ndihmuar edhe më shumë fëmijë në të ardhmen.



- Në vitin 2023, 20 fëmijë me aftësi të kufizuara në Handikos Ferizaj kanë marrë shërbime të edukimit jo-formal të përshtatura sipas nevojave të tyre. Këto shërbime kanë përfshirë aktivitete të personalizuara edukative dhe zhvillimore, të dizajnuara për të përmirësuar aftësitë e tyre sociale, emocionale dhe akademike. Programet janë hartuar për t'u ofruar këtyre fëmijëve një mjedis mbështetës, ku ata mund të zhvillohen në mënyrë të plotë, duke përfituar nga mësimet të strukturuar dhe të larmishme që përforcojnë pavarësinë dhe përfshirjen e tyre në shoqëri.



- Handikos Ferizaj ka ofruar shërbime psiko-sociale për gjithsej 18 fëmijë me aftësi të kufizuara. Këto shërbime kanë përfshirë mbështetje emocionale dhe ndërhyrje sociale, të dizajnuara për të përmirësuar mirëqenien e tyre dhe për t'i ndihmuar ata të integrohen më mirë në komunitet. Programet kanë qenë të përshtatura sipas nevojave individuale të secilit fëmijë, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive të tyre personale dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës.



AKTIVITETE GRUPORE

- Aktivitete Rekreative: Aktivitetet rekreative të cilat janë mbajtur një here në javë kanë pasur në fokus tema të cilat kanë ndihmuar përfituesit në pavarësim dhe socializim të tyre.
- Sesione informues: Këto sesione janë mbajtur me fokus tema të cilat kanë ndihmuar përfituesit në aspektin shëndetësor dhe në pavarësim të tyre.
- Aktivitete socializuese dhe rekreative: Këto aktivitete kanë përfshirë vizita në vende të ndryshme rekreative me qëllim që përveç argëtimit përfituesit dhe familjarët/kujdestarët e tyre të kenë mundësi të socializimit me njëri tjetrin.





AKTIVITETE NDERGJEGJESUESE

Në kuadër të aktiviteteve vetëdisuese, informuese me tema relevante për personat me aftësi të kufizuara përfshirë këtu edhe shënimin e ditëve ndërkombëtare të tilla si:

- Me moton “Të gjithë buzëqeshim në të njëjtën gjuhë” është shënuar 1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.
- Aktivitetet socializues. Aktiviteti kishte për qëllim edhe ndërgjegjësimin për rëndësinë dhe format e ruajtjes së mjedisit.
- LËVIZ SI UNË, ishte moto e aktivitetit të sotëm ndërgjegjëses për të shënuar 1 marsin – ditën ndërkombëtare të përdoruesve të karrocës.



Koncert:

"Rreze dielli në Dhjetor"

Shkolla e muzikës në bashkpunim me Handikos & Hendifer organizon koncert me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Data: 22.12.2023

Ora: 14:00

Vendi: Shfmu "Tefik Çanga"



■ SHËRBIMET PËR TE RRIJUR ME AFTËSI TE KUFIZUARA

• Shërbimet për të rritur:

Janë ofruar shërbime për 35 të rinj me aftësi të kufizuara, duke përfshirë mbështetje të vazhdueshme për nevojat e tyre specifike.

• Shërbimet psikologjike:


15 të rinj kanë marrë shërbime psikologjike, me një total prej 650 seancash të realizuara. Këto shërbime kanë ndihmuar në përmirësimin e mirëqenies emocionale dhe mendore të përfituesve, duke adresuar çështje të tilla si ankthi, depresioni dhe vështirësitë sociale.

• Trajnime në shkathtësi të buta:

Për 20 persona janë mbajtur trajnime për zhvillimin e shkathtësive të buta, si komunikimi, menaxhimi i kohës, dhe puna në ekip. Këto trajnime kanë pasur si qëllim përgatitjen e tyre për një integrim më të mirë në shoqëri dhe në tregun e punës.

• Aktivitetet sociale:

37 të rinj me aftësi të kufizuara kanë marrë pjesë në 8 aktivitete sociale dhe kreative të organizuara. Këto aktivitete kanë përfshirë punëtori, lojëra, dhe ngjarje të ndryshme, që kanë ndihmuar në nxitjen e ndërveprimit social dhe integrimin e tyre në komunitet.



■ SHËRBIME PËR PRINDËR TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Takime dhe Evente për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë mbajtur, përfshirë organizimin e aktiviteteve të ndryshme si festimi i 8 Marsit, Ditës së Gruas, për të ofruar mbështetje dhe për të fuqizuar prindërit në komunitetin e tyre. Këto Evente kanë shërbyer si platforma për të ndarë përvoja, për të diskutuar sfidat, dhe për të gjetur mënyra të përbashkëta për të përmirësuar jetën e fëmijëve me aftësi të kufizuara.



■ TAKIMET ME PALET E INTERESIT

Takimet me institucionet lokale kanë për qëllim të informojnë dhe të rrisin ndërgjegjësimin për nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara. Këto takime synojnë të krijojnë një dialog të hapur dhe konstruktiv me përfaqësuesit e institucioneve, duke identifikuar sfidat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara dhe duke propozuar zgjidhje konkrete që mund të përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre. Nëpërmjet këtyre diskutimeve, synohet gjithashtu të forcohet bashkëpunimi ndërmjet organizatave që mbështesin këtë komunitet dhe autoriteteve lokale, me qëllim krijimin e një mjedisi më gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.



- Konferenca të rëndësishme të dedikuara për përmirësimin e shërbimeve sociale. Konferenca e parë mbledhi përfaqësues nga organizata dhe institucione të ndryshme, ku u diskutua në detaje mbështetja dhe zhvillimi i shërbimeve sociale. Konferenca e dytë u përqendrua te institucionet lokale, ku u prezantua plani lokal i veprimit për shërbimet sociale, duke u shtruar rrugën për zbatimin e tij në nivel lokal.



Gjatë periudhës janar dhjetor 2023 janë mbajtur dy diskutime publike, që kanë synuar përmirësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuara në komunitet.

1. Diskutimi i listës së plotë të nevojave të personave me aftësi të kufizuara para institucioneve lokale. Ky diskutim ka pasur për qëllim të sigurojë që këto nevoja të njihen, të pranohen dhe të priorizohen nga institucionet lokale. Palët e interesuara, përfshirë përfaqësues të organizatave joqeveritare, institucioneve shtetërore, dhe familjarë të personave me aftësi të kufizuara, kanë diskutuar në detaje për këto nevoja, duke kërkuar veprime konkrete për të adresuar mungesat ekzistuese në shërbime dhe mbështetje.

2. Diskutimi i Planin Lokal të Veprimit për Shërbimet Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Ky diskutim ka mbledhur së bashku palët e interesuara për të shqyrtuar strategjitë e zbatimit të planit dhe për të diskutuar përmirësimet e mundshme. Në këtë diskutim, është theksuar rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit të shoqërisë civile për të siguruar që Plani i Veprimit të zbatohet në mënyrë efikase dhe të ndikojë pozitivisht në cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara. Palët kanë rënë dakord për nevojën e një qasjeje të koordinuar dhe përpjekjesh të vazhdueshme për të përmirësuar shërbimet sociale dhe për të mbështetur në mënyrë të qëndrueshme komunitetin.




- **Trajnimi dy ditor** “Konceptet e të drejtave të njeriut, rregullativës ligjore dhe shërbimet sociale për personat me aftësi të kufizuara” i cili ka pasur për qëllim rritjen e njohurive të përfaqësuesve të institucioneve, asamblistëve, organizatave të shoqërisë civile, prindërve/kujdestarëve të PAK rreth ligjeve dhe politikave të ndryshme që janë në fuqi për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.



- **Punëtorja treditore për hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Shërbimet Sociale**, në këtë punëtori u përfshi një grup i gjerë pjesëmarrësish. Në këtë proces morën pjesë Nën Kryetari i Komunës Drejtorë Komunalë, Asamblistë nga të gjitha subjektet politike, përfaqësues të institucioneve të ndryshme si Qendra për Punë Sociale (QPS) dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare (OJQ). Prindërit dhe kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara gjithashtu ishin të pranishëm, duke kontribuar me përvojat dhe perspektivat e tyre të vlefshme.

Gjatë këtyre tre ditëve, pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime të thelluara dhe punë grupore, ku u analizuan sfidat ekzistuese në ofrimin e shërbimeve sociale dhe u propozuan zgjidhje konkrete. Ky bashkëpunim i ngushtë ndërmjet aktorëve të ndryshëm siguroi që plani i hartuar të reflektojë nevojat dhe prioritetet reale të komunitetit.

Në përfundim të punëtorisë, u hartua një draft i Planit Komunal të Veprimit për Shërbime Sociale për Persona me Aftësi të Kufizuara që përmban masa dhe udhëzime të qarta për përmirësimin e shërbimeve sociale, me fokus të veçantë në përfshirjen dhe mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara. Planin përfundimtar pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në rritjen e cilësisë së jetës dhe aksesit në shërbime për të gjithë qytetarët.



- Gjatë vitit 2023, Handikos Ferizaj ka arritur të [publikojë disa materiale ndërgjegjësuere](#) për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me nevojat dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara. Këto materiale përfshijnë broshura informative, fletëpalosje dhe material video që ndihmojnë në edukimin e komunitetit dhe nxisin mbështetje për integrimin e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Përmes këtyre aktiviteteve, Handikos Ferizaj ka synuar të rrisë ndërgjegjësimin dhe të promovojë një mjedis më të hapur dhe mbështetës për të gjithë.
1. Listën e nevojave për personat me aftësi të kufizuara.
 2. Planin Lokal të Veprimit për Shërbimet Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara.
 3. Një video senzibilizuese për Shërbimet Sociale! #shërbimesocialehtetëqashmepërtëgjithë
 4. Një video senzibilizuese "Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë është obligim ligjor" #MosNeglizhoPunesiminTim!
 5. Katalogu i Ofruesve të Shërbimeve Sociale në Komunën e Ferizajt.



- Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, më 3 dhjetor, janë mbajtur dy ligjërata ndërgjegjësuere në komunën e Ferizajt. Këto ligjërata u zhvilluan në shkollat "Ahmet Hoxha" dhe "Astrit Bytyçi" ku u diskutua për rëndësinë e përfshirjes dhe barazisë për personat me aftësi të kufizuara. Qëllimi i këtyre ligjëratave ishte të edukohen nxënësit dhe mësuesit për sfidat dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe për të promovuar një mjedis shkollor më gjithëpërfshirës dhe pa diskriminim.



- Me rastin e festave të fundvitit, Handikos Ferizaj ka shpërndarë mbi 200 dhurata për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke sjellë gëzim dhe mbështetje për ta dhe familjet e tyre në këtë periudhë të veçantë




SHËRBIMET E PAJISJEVE NDIHMËSE

Handikos Ferizaj ka vazhduar të mbështesë personat me aftësi të kufizuara përmes ofrimit të pajisjeve ndihmëse për lëvizje, shërbim ky i cili ka mundësuar dhe kontribuar në pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, për më tepër ka kontribuar direkt edhe në përmbushjen e misionit tonë.

Përgjatë një viti, Handikos Ferizaj ka arritur që në mënyrë direkte të mbështesë 101 persona me aftësi të kufizuara (47G & 54 B) në Kosovë përmes ofrimit të pajisjeve të ndryshme ndihmëse. Nga ta, 13 ishin fëmijë me aftësi të kufizuara dhe 88 të rritur. Kryesisht përgjatë këtij viti janë shpërndarë karroca standarde, karroca tualeti, paterica dhe shëtitore.

Çdo përfitues, fillimisht është vlerësuar, përmes inventarëve vlerësues që Handikos Ferizaj posedon, inventarë të cilët pasqyrojnë nevojat e personit për përdorimin e pajisjes ndihmëse, si dhe specifikacionet e llojit të pajisjes ndihmëse dhe përmasave të saj. Pajisja ndihmëse është montuar dhe përshtatur me nevojat e përdoruesit të saj, përderisa të njëjtit janë trajnuar në përdorimin e shëndetshëm të pajisjes ndihmëse, mirëmbajtjen e shëndetit përgjatë përdorimit të pajisjes ndihmëse e gjithashtu edhe mirëmbajtjen e vetë pajisjes.



- Në vitin 2023, Handikos Ferizaj ka shënuar arritje të jashtëzakonshme në përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara. Disa nga sukseset kryesore përfshijnë:

1. Memorandum Mirëkuptimi tre palësh në mes Handikos Ferizaj, Komunës së Ferizaj dhe një grupi nga Mërgata në kuadër të aksionit Humanitar "Mërgata për Personat me Aftësi të Kufizuara" për ndërtimin e objektit për ofrim të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara



2. Vendorsja e gurthemelit për ndërtimin e qendrës së re: Falë mbështetjes së fuqishme nga diaspora dhe bizneset lokale në Ferizaj dhe rrethinë, dhe Komunës së Ferizajt e cila përveç parcelës ka lehtësuar edhe procedurat e lejes së ndërtimit dhe disa investime operative. Ky projekt synon të rrisë ndjeshëm kapacitetet për ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen për përfituesit.



3. Automjet Transporti: Për të përmirësuar transportin e përfituesve, Handikos Ferizaj ka pranuar një automjet të ri, të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara. Ky donacion, i mundësuar nga Bashkësia Islame në Ferizaj, dhe siguron transport të sigurt dhe të lehtë shtëpi-qendër-shtëpi për përfituesit.



VEPRIM, Ndërgjegjësim, Gjithëpërfshirje, Të
kuptuarit e aftësisë së kufizuar, Fëmijët me
aftësi të kufizuar, Rehabilitim, Planet e
veprimit, **Strategjia**, Promovimi i
dinjitetit, **Shërbime sociale**, Fuqizimi i personave
me aftësi të kufizuar, Mundësi të barabarta,
Punësimi, *Edukimi gjithëpërfshirës*,
Përfshirja sociale, Të drejtat e njeriut,
Gratë me aftësi të kufizuar,
Shërbime shëndetësore të
qasshme, Baza e të dhënave, **Ndal**
stigmatizimin dhe stereotipet

